



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

NR. 51, Datë 05/07/2022

**“PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” PËR Z. DHIMITËR FOTO
DHIMA”**

Në kuadër të vlerësimit të figurës së Z.Dhimiter Foto Dhima si dhe në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika (m) si dhe Ligjit Nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit", V.K.M Nr. 861, datë 10/12/2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimorë për dhënie të medaljeve dhe titujve vendorë të nderit", Këshilli i Bashkisë i mbledhur në datën 05/07 2022, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Drejtoria e Kulturës për dhënie titulli "Qytetar Nderi" për Z. Dhima Dhima, si dhe mbështetur në relacionin e Komisionit Vendor për dhënie të titujve të nderit,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënie të titullit **“Qytetar Nderi”** për Z. Dhimiter Foto Dhima (pas vdekjes) me motivacionin:

“Regjizor, aktor dhe libretist i Estradës së Qytetit të Gjirokastrës i cili me veprën e tij i shërbeu artit gjirokastrit duke lënë gjurmë në artin e kultivuar dhe ngritjen e grupeve amatore të qytetit”

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Trashëgimisë, Turizmit dhe Sporteve.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Lavdi Hasani

